



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PLANI PUNËS I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2020

Mars, 2020

Përmbajtja

1 Korniza ligjore dhe institucionale e KQZ-së	5
1.1 Baza ligjore	5
1.2 Mandati i KQZ-së	5
1.3 Përbërja dhe struktura KQZ-së.....	5
1.4 Sekretariati i KQZ-së	6
1.5 Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim	6
1.6 Komisionet Komunale të Zgjedhjeve	6
2 Procesi i hartimit të Planit të Punës - Metodologjia	6
3 Shtyllat dhe qëllimet strategjike të KQZ-së	8
4 Rreziqet dhe pengesat në zbatim	8
5 Raportimi	9
6 Plani i Aktiviteteve të Planit Vjetor të Punës së KQZ-së për vitin 2020.....	10

Hyrje

Plani i Punës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës (Plani i Punës) paraqet tërësinë e aktiviteteve që do të zbatohen në vitin 2020. Ky Plan i Punës bazohet në orientimet strategjike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të cekura në Planin Strategjik 2015-2018. Aktivitetet e parashikuara në Planin e Punës janë, po ashtu, në përputhje me parimet orientuese të punës të shprehura në të gjitha dokumentet e KQZ-së. Rrjedhimisht, të gjitha aktivitetet e parapara kontribuojnë në zbatimin e misionit të KQZ-së dhe në arritjen e objektivave të saj strategjike si dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së këtij institucioni.

Plani i Punës është hartuar mbi bazën të diskutimeve dhe me përfshirjen e të gjitha njësive strukturore të KQZ-së si dhe parterëve të jashtëm. Për më tepër, gjatë hartimit të këtij dokumenti janë konsultuar edhe rekomandimet e misioneve vendore dhe ndërkombëtare vëzhguese të zgjedhjeve.

Plani i Punës paraqet një dokument të integruar, për të cilin KQZ bie dakord për aktivitetet kryesore që KQZ duhet të zbatojë gjatë vitit 2020, me qëllim të arritjes së objektivave dhe orientimeve strategjike zhvillimore. Plani i Punës gjithashtu planifikon shpërndarje efektive të burimeve njerëzore dhe financiare të KQZ-së për të arritur objektivat e veta. Së bashku me arritjen e objektivave strategjike të KQZ-së, zhvillimi i Plani i Punës shërben, gjithashtu, për të mbështetur procesin e planifikimit dhe menaxhimit të aktiviteteve të KQZ-së për të ardhmen e sidomos duke pasur parasysh që Zgjedhjet Lokale do të mbahen në vitin 2021, e Plani i Punës parashikon aktivitete që mund të përmirësojnë atë proces zgjedhor.

Për fund, Plani i Punës i KQZ-së është hartuar sipas metodologjisë standarde të KQZ-së për hartimin, aprovimin, korigjimin dhe zbatimin e planeve vjetor të punës dhe të cilat miratohen nga KQZ-ja. Plani i Punës zhvillohet në bazë të informacionit të mbledhur dhe analizuar nga njësitë strukturore të KQZ-së. Dokumenti përfundimtar i Plani i Punës erdh si rezultat i punës së përbashkët të KQZ-së dhe drejtuesve të njësive strukturore të SKQZ-së. Dokumenti thekson qartë objektivat strategjike, aktivitetet e planifikuara për të arritur këto objektiva, treguesit e matshëm, rezultatet e pritura, burimet, si dhe përcakton njësitë strukturore përgjegjëse.

Shkurtesat

ACEEEO	Asociacioni i Zyrtarëve Zgjedhor Evropian
KKZ	Komisionet Komunale të Zgjedhjeve
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Këshillat e vendvotimeve
OJQ	Organizatat Jo Qeveritare
OSCE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim ne Evropë
QNR	Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve
QV	Qendra e Votimit
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
VV	Vendvotim
SHV	Shërbimi Votues
LV	Lista e Votuese
ZFK	Zarfi i Fletëvotimit me Kusht
FPR	Formulari i Përputhjes së Rezultateve
FRK	Formulari i Rezultateve të Kandidatëve
DAP	Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes
DOZ	Departamenti i Operacioneve Zgjedhore
DTI	Departamenti i Teknologjisë Informative
DKT	Departamenti i Koordinimit ne teren
KOZ	Këshilli për Operacione Zgjedhore
KP	Këshilli për Personel
KBF	Këshilli për Buxhet dhe Financa
KA	Komiteti i Auditimit
KÇL	Këshilli për Çështje Ligjore
KMJ	Këshilli për marrëdhënie me jashtë
ZRPP	Zyra për Regjistrim të Partive Politike

1 Korniza ligjore dhe institucionale e KQZ-së

1.1 Baza ligjore

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm dhe i pavarur, i përcaktuar me nenin 139 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës¹.

Me qëllim të organizimit të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendin e Kosovës, për Kuvendet e Komunave dhe Kryetarët e Komunave, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe ligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Aspektin e financimit të subjekteve politike e rregullon Ligji për Financimin e Partive Politike. Ai rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për shpenzimin e pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka plotësuar kornizën ligjore duke nxjerrë 20 rregulla të cilat, sqarojnë dispozitat e ligjit dhe japin më shumë hollësi, se si të zbatohen ato në praktikë. Ato trajtojnë aspektet kryesore të procesit zgjedhor. KQZ-ja ka miratuar edhe Rregulloren e Punës, si akt i brendshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që përcakton organizimin dhe mënyrën e funksionimit të tij.

1.2 Mandati i KQZ-së

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

Kompetencat e KQZ-së

Gjatë zbatimit të mandatit të vet KQZ-ja:

- a) ndërmerr aktivitete për edukimin e votuesve të përgatitura për ngritjen e vetëdijesimit të votuesit për zgjedhjet dhe pjesëmarrjen to;
- b) ndërmerr projekte ose kërkime lidhur me sistemin zgjedhor dhe çështjet lidhur me të;
- c) krijon procedura të përshtatshme dhe ndërmerr aktivitete për të garantuar që të gjithë personat me aftësi të kufizuara mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit dhe të marrin pjesë tërësisht në procesin zgjedhor në Kosovë; dhe
- d) kryen çdo funksion tjetër ndihmës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë që i përcaktohet me rregulloret relevante dhe instrumentet ndihmëse, përfshirë veprimet e domosdoshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor në rast shfaqjeje të një force madhore.

1.3 Përbërja dhe struktura KQZ-së

Përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është e përcaktuar me Kushtetutë². Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës

¹ Kapitulli XII [Institucionet e Pavarura], Neni 139, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

² . Neni 139, paragrafët 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli. Gjashtë anëtarë të tjerë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuar në Kuvend. Një anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës, dhe tre anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë. Në kryerjen e përgjegjësive dhe funksioneve të tij, Komisionit i ndihmon Sekretariati i KQZ-së.

1.4 Sekretariati i KQZ-së

Sekretariati i KQZ-së është një trupë administrative-teknike, e themeluar nga KQZ-ja për të ndihmuar KQZ-në në kryerjen e përgjegjësive dhe të funksioneve të saj. SKQZ-ja i zbaton vendimet e KQZ-së, përgatit raporte dhe rekomandime për KQZ-në.

1.5 Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim

KQZ-ja në pajtueshmëri me ligjin, ka themeluar Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPP). ZRPP-ja, është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe azhurnimin e Regjistrimit të Partive Politike, për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për zgjedhje, certifikimin e vëzhguesve të zgjedhjeve, kufizimin e shpenzimeve të subjekteve të certifikuar politike gjatë fushatave, si dhe pranimin e deklarimeve të financave të kandidatëve për zgjedhje.

1.6 Komisionet Komunale të Zgjedhjeve

KKZ-të janë trupa të themeluara nga KQZ-ja në tridhjetetë (38) komunat e Republikës së Kosovës për të ndihmuar në organizimin e zgjedhjeve. Ato janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve përbrenda komunave, nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e KQZ-së nëpërmjet Sekretariatit, me qëllim të garantimit të ligjshmërisë, legjitimitetit dhe efikasitetit të procesit zgjedhor.

2 Procesi i hartimit të Planit të Punës - Metodologjia

Sekretariati i KQZ-së në muajin dhjetor të vitit 2019, ka mbajtur një takim pune ku të gjitha njësitë e Sekretariatit kanë raportuar për përmbushjen e Planit Vjetor të Punës për vitin 2019 edhe mësimet e nxëna nga proceset zgjedhore të vitit 2019.

Më tej, KQZ bashkë me Sekretariatit nga data 19 deri me 22 dhjetor 2019, kanë mbajtur një punëtori, me prezencën e përfaqësuesit nga Bashkimi Evropian, ku janë diskutuar te gjeturat e Sekretariatit për mësimet e nxëna nga zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2019. Pastaj, Sekretariati ka identifikuar aktivitetet që kanë mbetur pa u realizuar në vitin 2019 edhe aktivitetet tjera që janë nxjerr nga të gjeturat e vlerësimeve të brendshme për proceset zgjedhore të vitit 2019.

Më përkrahjen e OSBE-së, KQZ ka mbajtur punëtori nga data 23 deri me 26 janar 2020, ku është bërë vlerësimi i përmbushjes së Planit të Punës për vitin 2019, dhe janë identifikuar aktivitetet që duhet të barten në këtë vit. Po ashtu, është punuar në 3 grupe punuese (të përbëra nga Anëtarë të KQZ-së, zyrtar nga Sekretariati dhe përfaqësues nga OSBE), ku janë identifikuar aktivitetet e reja për implementim në vitin 2020.

Gjatë hartimit të Planit të Punës janë marrë për bazë rekomandimet e evidentuara në raportet e monitorimit të zgjedhjeve të fundit të vëzhguesve të Bashkimit Evropian dhe Koalicionit të OJQ-ve Demokracia në Veprim përbrenda kornizës aktuale ligjore. Plani synon që të përmirësojë proceset dhe shërbimet e KQZ-së në funksion të përgatitjes për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen në vitin 2021 dhe proceset tjera në vazhdim.

3 Shtyllat dhe qëllimet strategjike të KQZ-së

KQZ-ja me qëllim të caktimit të objektivave zhvillimore ka identifikuar shtyllat kryesore strategjike si në vijim:

- 1) **Operacionet zgjedhore**- me synimin që aktivitetet zgjedhore të planifikohen me saktësi, të ketë procedura të thjeshtëzuara, votimi të jetë plotësisht i qasshëm, dhe të ketë rezultate që janë të sakta dhe të shpejta;
- 2) **Edukimi dhe informimi i votuesve** – me synimin që votuesit të jenë të informuar për të drejtat zgjedhore dhe të motivuar për rëndësinë e realizimit të tyre, të ketë komunikim të përhershëm me publikun në format të qasshëm, dhe që votuesit të jenë të informuar për procedurat dhe mënyrën e votimit;
- 3) **Fuqizimi institucional** - me synimin që të ruhet plotësisht stafi që tashmë është i trajnuar, profesional dhe gjithëpërfshirës, të ketë komunikim më efikas institucional, KKZ-të dhe KVV-të të jenë edhe më kompetente dhe efektive, struktura organizative të jetë në pajtim me qëllimet e KQZ-së, të sigurohet qëndrueshmëri financiare, si dhe të hartohet një kornizë rregullative gjithëpërfshirëse për funksionimin e brendshëm;
- 4) **Lista e votuesve** – me synimin që përfundimisht të arrihet një listë e votuesve e saktë dhe e plotë;
- 5) **Pjesëmarrja në zgjedhje** – me synimin që të ketë pjesëmarrje më të madhe në zgjedhje, të ketë qasje të barabartë dhe gjithëpërfshirëse në zgjedhje dhe të rritet besueshmëria e publikut në procesin zgjedhor;
- 6) **Inovacioni dhe teknologjia** – me synimin që të rritet përdorimi i teknologjisë për operacione zgjedhore, të rritet përdorimi i teknologjisë në shërbimet administrative, të ngritën njohuritë në aplikimin e teknologjisë në zgjedhje;
- 7) **Bashkëpunimi me akterët e jashtëm** – me synimin që të arrihet një partneritet dhe komunikim më i mirë me subjektet politike, shoqërinë civile dhe mediat, të zhvillohet një bashkëpunim i zgjeruar strategjik me organizatat ndërkombëtare dhe donatorët, të ketë bashkëpunim më efikas me institucionet vendore, dhe të promovohet më mirë KQZ-ja në nivelin ndërkombëtar;
- 8) **Korniza ligjore**– me synimin që korniza nënligjore të jetë në përputhje me ligjet e vendit dhe standardet ndërkombëtare, KQZ-ja të jetë akter kyç në procesin e reformave zgjedhore dhe KQZ-ja të ketë një kornizë të plotë dhe efektive nënligjore.

4 Rreziqet dhe pengesat në zbatim

Gjatë hartimit të këtij Plani, janë evidentuar rreziqet dhe pengesat që mund të hasen në implementimin e Planit të Punës për këtë vit, e të cilat mund të jenë:

- a) **Kufizimet buxhetore apo vonesa e aprovimit të buxhetit**, ku do të ndikonte sidomos në realizimin e projekteve kapitale por edhe në aktivitetet tjera, për shkak se planifikimi është bërë mbi bazën e kufijve buxhetorë të qarkores së vitit 2019 për shkak se Ligji i Buxhetit ende nuk është aprovuar.

- b) **Largimi i mbështetjes së donatorët**, do të ndikonte në mosrealizimin e disa nga aktiviteteteve që janë paraparë të implementohen me mbështetjen e donatorëve.
- c) **Mbajtja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme**, pamundëson realizimin në kohë të disa aktiviteteteve apo edhe mosrealizimin për shkak të volumit të angazhimit të stafit.

5 Raportimi

Ashtu siç është cekur gjatë procesit të hartimit, redaktimit dhe aprovimit të Planit të Punës, drejtuesit e njësive strukturore të KQZ-së, gjegjësisht personat përgjegjës, i paraqesin raporteve tremujore Kryeshefit të SKQZ-së, ndërsa ai përgatit raport përmbledhës për progresin e zbatimit të Planit Vjetor të Punës në baza tremujore për KQZ-në.

Bazuar në informacionin e marrë, Zyra e Kryeshefit të KQZ-së përgatit raportin tremujor dhe të ia dërgon KQZ-së. Pastaj, në fund të vitit, hartohet edhe një raport i konsoliduar vjetor (Raporti vjetor) i cili mund të bëhet publik, gjegjësisht të publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Në periudhën e ndërmjetme mund të mbahen takime të rregullta ndërmjet KQZ-së dhe drejtuesve të njësive të saj strukturore të SKQZ-së dhe do të vlerësohet procesi i zbatimit të Planit të Punës. Në fund të vitit raportues, KQZ dhe drejtuesit e njësive të saj strukturore të SKQZ-së mbajnë mbledhjen ku pjesëmarrësit prezantojnë dhe vlerësojnë raportet përmbledhëse për zbatimin e aktiviteteteve të përcaktuara me Planin e Punës, si dhe zbatimin e aktiviteteteve të tjera mbështetëse.

6 Plani i Aktiviteteve të Planit Vjetor të Punës së KQZ-së për vitin 2020

Shënim: Aktivitete e listuara për muajt Janar dhe Shkurt të vitit 2020 tashmë janë zbatuar ose janë në proces të përgatitjes së raportit të zbatimit të tyre.

Nr	Aktivitetet	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia përgjegjëse	Personi përgjegjës	Afati kohor												Raportimi	Treguesit e performances	Vlerësimi i resurseve	
					I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII			Kosto	Burimi
Shtylla Strategjike - Operacionet Zgjedhore																				
1	Analizimi i vendotimeve të rinumëruara në QNR nga zgjedhjet 2009 - 2019	Aktiviteti ka për qëllim analizimin e gjithë vendotime të cilat i janë nënshtruar procesit të rinumërimit në QNR dhe arsyet që kanë dërguar në rinumërim. Analiza përfshin proceset 2009 – 2019.	QNR	Burim Ahmetaj													Q2,Q3	1. Raporti i hartuar 2. Raporti I aprovuar	Pa kosto shtesë	KQZ
2	Zhvillimi i Strategjisë për modernizimin e QNR-së	Ky aktivitet synon të fillojë zhvillimin e një strategjie për modernizimin dhe rritjen e efikasitetit të operacioneve të QNR. Kjo do të përfshijë shqyrtimin e mundësive të përshtatshme që mund të jenë në dispozicion dhe me kosto efektive si dhe teknologjinë që mund të përdoret për mbështetje operacioneve të QNR-së. Kjo strategji do konsideroj edhe implikimet ligjore dhe procedurale të përdorimit të çfarëdo teknologjie të tillë. Edhe pse nuk pret ndryshime të mëdha në sistemet aktuale që përdoren në QNR por rekomandimet e rrjedhura nga ky rishikim do synohen të zbatohen para fillimit të zgjedhjeve të planifikuara të vitit 2021.	QNR	Burim Ahmetaj													Q1,Q2	1. Dokumenti i finalizuar 2. Dokumenti i aprovuar	Pa kosto shtesë	KQZ
3	Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për fletëvotimet e pavlefshme për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019	Analizimi i fletëvotimeve të pavlefshme të shoqëruara me vlerësimin e Sekretariatit të KQZ-së për fletëvotimet e pavlefshme.	QNR	Burim Ahmetaj													Q1,Q2	1. Dokumenti i finalizuar 2. Dokumenti i aprovuar	Pa kosto shtesë	KQZ
4	Shqyrtimi, aprovimi dhe publikimi i trendëve zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019	Hartimi dhe publikimi i dokumentet me të dhënat statistikore për daljen e votuesve në zgjedhje, të ndarë në grup moshë, gjini, komuna, etj.	QNR/DTI	Burim Ahmetaj													Q2,Q3	1. Nxjerrja e të dhënave , klasifikimi 2. Hartimi i raportit 3. Aprovimi dhe publikimi	500 Euro	KQZ
5	Hartimi i Raportit “Analizë e votave me asistencë për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 6 tetor 2019”	Analiza e votave me asistencë për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, datë 6 tetor 2019". Formimi i komisionit për hartimin e raportit “Analizës së votave me asistencë për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, datë 6 tetor 2019”	DOZ	Besnik Buzhala													Q1, Q2	1. Raporti i hartuar 2. Raporti i aprovuar	Pa kosto shtesë	KQZ
6	Hartimi i Planit Strategjik të KQZ-së 2020-2024	KQZ do të vlerësojë zbatimin e planit strategjik 2015 - 2018, dhe do të hartojë Planin Strategjik për periudhën 5 vjeçare (2020 - 2024) i cili do të pasohet me një plan të veprimit për zbatim të këtij plani strategjik.	Grup mix: KQZ/ SKQZ	Kryesuesi i Grupit Punues													Q1,Q2,Q3, Q4	1. Metodologjia e aprovuar, 2. Plani indikativ i aktiviteteve, 3. Raporti i zbatimit të strategjisë 2015 - 2018, 4. strategjia, e hartuar dhe aprovuar	10,000,00	Donator / KQZ

Shtylla Strategjike - Operacionet Zgjedhore																		
7	Analizë për metodat alternative për shënim të votuesve që kanë votuar (me ngjyrë të padukshme ose ngjyrë matrikuluese)	Shqyrtimi i praktikave rajonale dhe botërore me qëllim të thjeshtëzimit të procedurave dhe zvogëlimit të kostos.	KQZ	Fatos Lika											Q2,Q3	1. Vizita studimore, 2. Raporti final me praktikat -analizën	Pa kosto shtesë	Donator ë/ KQZ
8	Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i planit final të prokurimit për vitin 2020	Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, duhet t'i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit fiskal.	Prokurimi	Nexhmi Haxhiu											Q1	Plani i Prokurimit	Pa kosto shtesë	KQZ
9	Implementimi i Planit të Prokurimit për vitin 2020	Implementimi i Planit të Prokurimit për vitin 2020, duke zhvilluar aktivitetet e parapara me plan për prokurimin e shërbimeve apo furnizimeve.	Prokurimi	Nexhmi Haxhiu											Q2, Q3, Q4	Raporti vjetor I prokurimit	Pa kosto shtesë	KQZ
10	Hartimi i planit preliminar të prokurimit për vitin 2021	Jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë planifikimin paraprak të prokurimit, të dorëzojë me shkrim të Zyrtares Kryesore Administrative të Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit të ardhshëm fiskal.	Prokurimi	Nexhmi Haxhiu											Q4	Plani preliminar I prokurimit	Pa kosto shtesë	KQZ
11	Dorëzimi i raportit lidhur me kontratat e prokurimit për vitin 2019	Përgatitja dhe raportimi i kontratave të nënshkruara për vitin paraprak, I njëjti duhet të dorëzohet në KRPP.	Prokurimi	Nexhmi Haxhiu											Q1	Raporti vjetor I prokurimit	Pa kosto shtesë	KQZ
12	Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2021 - 2023	Korniza Afatmesme të Shpenzimeve 2021 - 2023 është dokument që i paraprinë procesit buxhetor dhe shërben për realizimin e strategjisë dhe qëllimeve të KQZ-se përmes objektivave që realizohen përmes aktiviteteve dhe projekteve në një vit të rregullt buxhetor. ky dokument në MF dorëzohet në fillim të muajit prill.	DAP	Miradije Meha											Q2	1.Finalizimi i dokumentit me kërkesat e njëjësive për 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i dokumentit në KQZ 3. Dokumenti i dërguar në Ministrinë e financave me kohë	Pa kosto shtesë	KQZ
13	Hartimi i Planit të Buxhetit 2021-2023	Pas shqyrtimit të KASH 2021 - 2023 nga Kuvendi i Kosovës, fillon procesi i hartimit të Planit të Buxhetit 2021-2023 të KQZ-se. Hartimi i Planit të Buxhetit bazohet në kërkesat buxhetore të cilat janë të bazuara në plane dhe projekte të njëjësive kërkuese.	DAP	Miradije Meha											Q2,Q3	1.Finalizimi i dokumentit me kërkesat buxhetore 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i buxhetit 3. Plani i dërguar në Ministrinë e financave me kohë	Pa kosto shtesë	KQZ
14	Zbatimi i Buxhetit të KQZ-së	Hartimi dhe aprovimi i Planit të rrjedhës së parasë. 2.Shpenzimi i buxhetit. 3.Rishikimi i buxhetit 4. Transferi i buxhetit të subjekteve politike. 4.Raporti vjetor financiar për vitin 2019. Këtë raport e dorëzojmë në MF më së voni me 30 janar 2020.	DAP	Miradije Meha											Q1,Q2,Q3, Q4	1.Plani i finalizuar 2.Rishikimi i kërkesave buxhetore 3. Hartimi dhe aprovimi i raportit financiar vjetor.	Pa kosto shtesë	KQZ

Shtylla Strategjike - Operacionet Zgjedhore

15	Shkatërrimi i materialeve te ndjeshme nga zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune 2019 dhe Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019.	Do të shkatërrohen materialet e ndjeshme nga dy palë zgjedhjet e vitit 2019, do të fillohet me procedurën e prokurimit për kontraktimin e kompanisë për shkatërrim të materialit. Do të formohet komisioni për mbikëqyrjen e këtij aktiviteti.	Divizioni i Logjistikes	Drejtori i DAP-it											Q1, Q2	Asgjësimi I materialit	1,000.00	KQZ
16	Evidentimi i materialeve Zgjedhore me afate te skaduar dhe që nuk janë subjekt i shqyrtimit gjyqësorë si dhe asgjësimi i tyre.	Do të formohet komisioni për evidentimin e materialeve të skaduar dhe atyre që nuk janë më subjekt i shqyrtimit gjyqësor si dhe asgjësimi i tyre sipas natyrës së artikujve.	Divizioni i Logjistikes	Drejtori i DAP-it											Q1, Q2	Asgjësimi I materialit	1,500.00	KQZ
17	Përgatitja e termave të referencës për materiale zgjedhore dhe jo zgjedhore.	Rishikimi i termave dhe specifikimeve pakove me materiale administrative dhe formave zgjedhore sipas rekomandimeve të prokurimit.	DCL/DAP/DOZ/QNR	Drejtori i DAP-it											Q2, Q3	1. Specifikat e hartuara 2. Numri i rekomandimeve (ndryshmeve) të plotësuara 3. Dokumentet e aprovuara	Pa kosto shtesë	KQZ
18	Punëtori për mësimet e nxënë	Organizimi i një punëtorie për mësimet e nxëna, ku do te diskutohen dhe identifikohen mësimet e nxëna nga implementimi i aktiviteteve gjate vitit 2020. Punëtorja gjithashtu do te shërbej për planifikimin e aktiviteteve te vitit 2021. Punëtorja do te jete ngjarje dy ditore me pjesëmarrës, duke përfshirë anëtarët e KQZ-se, Sekretariatit dhe stafin e OSBE-se dhe do të mbështetet nga OSBE.	SKQZ	Haki Krasniqi											Q4	1. Raporti me rekomandimet nga takimi	Pa kosto shtesë	OSCE
19	Përkrahja në implementimin e projektit te ODIHR-it	OSBE do te ofroj mbështetje teknike ne implementimin e projektit te ODIHR-it "Mbështetje për përcjelljen e rekomandimeve zgjedhore në Ballkani Perëndimor ". Aktiviteti do të përfshijë vlerësimin e nevojave në lidhje me programin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve në koordinim të ngushtë me ODIHR. Ky është një aktivitet pa kosto.	QNR	Burim Ahmetaj											Q3,Q4		Pa kosto shtesë	OSCE

Shtylla Strategjike - Edukimi dhe informimi i votuesve

20	Shqyrtimi, miratimi dhe realizimi i projektit “Shënimi i ditës globale të zgjedhjeve”	Tryezë me akterët e jashtëm "Bashkëpunimi në procesin zgjedhor" ZLKZ-të do të organizojnë takime dhe do të mbajnë ligjërata me votuesit e rinj-maturantët për të drejtën e votës dhe për rëndësinë e pjesëmarrjes së zgjedhjeve.	DOZ/DKT/ DTI/DAP	Azeme Beqiri											Q1	1.Dita globale e shënuar/mbajtur 2.Raporti përmbledhës mbi realizimin e projektit “Shënimi i ditës Globale të Zgjedhjeve	5,000.00	KQZ
21	Hartimi i Strategjisë së Informimit Publik për Zgjedhjet Lokale 2021	Hartimi i Strategjisë ka për qëllim informimin dhe edukimin e votuesve dhe palëve tjera relevante lidhur me zgjedhjet, për rritjen e pjesëmarrjes në votim dhe, për rrjedhojë, minimizimin e të gjitha elementeve, të cilat mund të cenojnë integritetin e procesit zgjedhor, uljen e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme, si dhe ndërgjegjësimin e qytetareve për rolin e tyre në mbajtjen e një procesi të rregullt zgjedhor. Gjatë përgatitjes së strategjisë do të analizohen të gjeturat nga raporti i projektit “Analizë e efektivitetit të fushatës së Informimit Publik” të cilat do të shfrytëzohen për hartimin e strategjisë së IP.	DOZ	Azeme Beqiri											Q3,Q4	1. Strategjia e hartuar, 2. Strategjia e aprovuar	Pa kosto shtesë	KQZ
22	Shqyrtimi, miratimi dhe zbatimi i Planit të veprimit për adresim të rekomandimeve nga raportet e vëzhguesve të Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare 2019	DOZ me ekspertizën e nevojshme do të hartoj një plan të veprimit për adresim të rekomandimeve brenda fushë-veprimtarisë së KQZ, të raporteve përfundimtare të vëzhguesve të BE-së për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në konsultim me departamentet përgjegjëse të SKQZse dhe partneret e jashtëm. Plani duhet të shqyrtohet dhe të miratohet në KOZ/KQZ	DOZ	Haki Krasniqi											Q1,Q2,Q3, Q4	1. Plani i veprimit i aprovuar	Pa kosto shtesë	KQZ

Shtylla Strategjike - Fuqizimi Institucional

23	Rishikim i strukturës së ZRPPC dhe organogramit për periudhat jozgjedhore (stafi permanent) dhe zgjedhore (stafi jo-permanent)	Në proceset zgjedhore paraprake por edhe në aktivitetet e zakonshme të Zyrës është vërejtur se struktura organizative e Zyrës dhe orgaogrami i sajë mund të përmirësohet me qëllim të efikasitetit dhe efikasitetit. Shqyrtimi do të prodhojë një raport gjithëpërfshirës për periudhën jo-zgjedhore (stafi permanent) dhe periudhën zgjedhore (stafi jopermanent).	ZRPPC	Yll Buleshkaj											Q2	1. Metodologjia e rishikimit 2. Raporti i finalizuar 3. Raporti i aprovuar	Pa kosto shtesë	KQZ/Donator
24	Miratimi i Planit të Trajnimit 2020	Divizioni i trajnimit do të përgatit dy propozime projekte të trajnimit Trajnim për përfaqësues të subjekteve politike duke aplikuar dy faza të implementimit, në nivel qendror. Trajnimin me temën të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve ditën e zgjedhjeve Aktivitetet do të kenë disa faza të realizimit, duke filluar nga trajnimi i ZLKZ-ve e deri tek zhvillimi i trajnimeve për përfaqësuesit të cilët do të përcjellin trajnimin respektiv. Targetet dhe numri i pjesëmarrësve do të caktohen sipas propozimeve në narrativ të projektit.	DOZ/DKT/ZRPPC	Valbona Kida											Q2,Q3,Q4	1.Hartimi i Planit të Trajnimit 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit 3. Zbatimi i planit	10,000,00	KQZ
25	Rishikimi dhe plotësimi i doracakut të trajnimit	Shqyrtimi i mostrave për definimin e qartë të fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme dhe vendimet e PZAP. Plotësimi i Doracakut të trajnimit me propozime nga rekomandimet e dhëna nga KQZ. Komisioni i caktuar nga KE-ja, do të bëjë grumbullimin e mostrave të caktuara dhe do të paraqes për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Operacioneve dhe në KQZ.	DOZ/ QNR	Valbona Kida											Q1,Q2,Q3, Q4	1.Numri i rasteve të fletëvotimeve që përfshihen në doracak. 2. Doracak i finalizuar 3. Doracak i aprovuar	Pa kosto shtesë	KQZ
26	Identifikimi i mungësive të trajnimit të trupave zgjedhore	Organizimi i 6 takimeve në regjione lidhur me analizimin e procesit të trajnimit. Tema të agjendes do të jenë: Modulet e trajnimit për trajnimin e trajnereve, Modulet e trajnimit për trajnim të anëtarëve të KKZ-ve, Modulet e trajnimit për trajnim të anëtarëve të KVV-ve, Modulet e trajnimit për trajnim për anëtarëve të ekipeve mobile dhe procedurat e pranimit dorzimit të materialit zgjedhor në KKZ .	DOZ/DKT/QNR	Valbona Kida											Q1,Q2,Q3, Q4	Te merren parasysh raportet e QNR-se lidhur me kategorizimin e të gjitha materialeve të pranuar nga ZLKZ-te ditën e Zgjedhjeve	5,000,00	KQZ

Shtylla Strategjike - Fuqizimi Institucional

